

- **Hapet Zyra e Përfaqësimit të Diamantit në Kosovë**

Për të lehtësuar komunikimin dhe për të qenë, me gamën e shërbimeve, më pranë kompanive në Kosovë Diamant hapi zyrën e saj në Kosovë.

Duke ndjekur me interes dhe vëmëndje të veçantë zhvillimet ekonomike dhe tendencën në rritje të nevojave të kompanive të shumta në Kosovë për shërbimet e transportit si rajonal dhe ndërkombëtar nëpërmjet kësaj zyre besojmë se do të rritet dhe intensifikohet bashkëpunimi me shumë kompani të Kosovës. Theksojmë se Diamant ka një historik të pasur dhe të shtrirë në kohë të bashkëpunimit me kompanitë nga Kosova.